



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Departamenti i Prokurimit

Komuna e Lipjanit: datë 06.04.2022

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Lipjanit, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 04.04.2022, të parashtruar nga Operatori Ekonomik, "Er-Lis" shpk nga Peja, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Mirëmbajtja e sinjalizimit horizontal dhe vertikal në Komunën e Lipjanit" me Nr. të Prok: 613-22-635-2-2-1

V E N D I M

I Refuzohet, kërkesa për ri-shqyrtim e Operatorit Ekonomik "Er-Lis" shpk nga Peja të dt. 04.04.2022 lidhur me aktivitetin e prokurimit "Mirëmbajtja e sinjalizimit horizontal dhe vertikal në Komunën e Lipjanit", me nr. të Prok: 613-22-635-2-2-1

Vërtetohet Vendimi i AK për shpërblim me kontratë për Operatorin Ekonomik "Sinjal" shpk nga Ferizaj. Mbetet në fuqi Vendimi i AK për shpërblim me kontratë i publikuar me datë: 29.03.2022

1. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit të lartëpërmendur.
2. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

A r s y e t i m

Operatori Ekonomik "Er-Lis" shpk nga Peja, me datë 04.04.2022 ka parashtruar kërkesë për ri-shqyrtim lidhur me aktivitetin e prokurimit "Mirëmbajtja e sinjalizimit horizontal dhe vertikal në Komunën e Lipjanit" me nr. të Prok: 613-22-635-2-2-1 ku këtë aktivitet AK ka shpallur fitues Operatorin Ekonomik "Sinjal" shpk nga Ferizaj, **për shpërblim me kontratë** të datës 29.03.2022 dhe ka publikuar në platformën elektronike e-prokurimi.

Operatori Ekonomik "Er-Lis" shpk nga Peja, me datë. 04.04.2022 ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim lidhur me aktivitetin e prokurimit "Mirëmbajtja e sinjalizimit

horizontal dhe vertikal ne Komunën e Lipjanit” Autoriteti Kontraktues, me datë 06.04.2022, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Sa i përket pretendimit tuaj të parë në lidhje me referencat dhe paisjet teknike Autoriteti Kontraktues konsideron se ju nuk keni referenca të ngjashme të mjaftueshme në tri vitet e fundit duke filluar nga data e publikimit të njoftimit për kontratë. Po ashtu nuk keni edhe dëshmi për disa paisje teknike të cilat i kemi cekur edhe në letren standarde për eliminimin tuaj.

Sa i përket pretendimit tuaj të dytë mbi mundësitë teknike dhe profesionale, komisioni vlerësues në bazë të njohurive profesionale i ka vlerësuar dhe i ka trajtuar të gjithë Operatorët Ekonomik të barabartë. Sa i përket Autorizimit të prodhuesit (apo distributorit të autorizuar) për çdo produkt që perdoret për sinjalizim horizontal dhe vertikal, ky autorizim në bazë të dëshmive të AK-së është kërkuar kopje psh Kopja e Autorizimit të prodhuesit (apo distributorit të autorizuar)

Sa i përket deklaratave nën betim të gjithë Operatorët Ekonomik i kanë këto deklarata. Sa i përket çmimit jo normalishtë të ulët, sipas legjislacionit në fuqi të Prokurimit Publik, te tenderët me çmim të peshuar nuk aplikohet tenderi jo normalishtë i ulët. Në rast të çmimit më të ulët, duke peshuar çmimet, çmimet e peshuara bazohen në çmimin e ofruar nga Operatorët Ekonomik individual, prandaj nuk lejohet që të përcaktohen pikët duke krahasuar çmimet e ofertuesve të ndryshëm.


AK, konsideron se tenderi juaj është vlerësuar me kujdes dhe ka zbatuar me përpikëri rregullat e nxjerra nga KRPP

Drejtori i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa pranë OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimiit te ketij vendimi.

Bekim Shabani



Drejtor i Prokurimit